



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:186176
Datë: 13.03.2024
Numri i dokumentit: 05447276

2023:186177

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në çështjen juridike të paditësit F.T. nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson me autorizim av. Dalip Bega nga Ferizaj, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë me seli në Prishtinë, për kompensimi ne shujtës ditore dhe pagën e 13, jashtë seancës gjyqësore me datë 13 mars 2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET padia C.nr.2023:186177 e paditësit F.T. nga Ferizaj e parashtruar kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë me seli në Prishtinë, për kompensimi ne shujtës ditore dhe pagën e 13 për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, për shkak të ekzistimin të gjyqëvarësisë (litispencencës).

A r s y e t i m i

Paditësi F.T. nga Ferizaj ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datë 01.09.2023 kundër të Ministria e Punëve të Brendshme- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë me seli në Prishtinë, për kompensimi ne shujtës ditore dhe pagën e 13-të.

Gjykata konform dispozitave ligjore i ka dërguar të paditurës Aktvendimin për përgjigje në padi, padinë dhe shkresat e lëndës, dhe e paditura me datë 07.03.2024 gjykatës i kanë deklaruar se paditësi F.T. nga Ferizaj për çështjen e njëjtë ka parashtruar edhe një padi në Gjykatën Themelore Prishtinë e cila evidentohet me nr C.nr.6958/21, e cila padi është ka të bëjë me kontestin e njëjtë si në lëndën aktuale, pra paditësi kërkon nga e paditura kompensimin e pagës së 13 për vitet

2018, 2019, 2020 dhe 20121 dhe shpërblimin jubilar, dhe kanë kërkuar nga gjykata që të hudhet padia për shkak të ekzistimit të gjyq varësisë(litispendencës).

Gjithashtu gjykatës i kanë dorëzuar si provë Padinë C.nr.6958/21 të datës 03.12.2021 të dorëzuar në Gjykatën Themelore Prishtinë.

Gjykata pasi analizoi të dy lëndët C.nr.6958/21 dhe lëndën aktuale C.nr.2023:186177, gjeti se bëhet fjalë për çështjen e njëjtë, palët e njëjta dhe kontestin e njëjtë mirëpo meqenëse lënda C.nr. 6958/21 është lëndë më e vjetër pra lëndë e iniciuar me datë 03.12.2021 pra është proceduar më herët dhe e njëjta gjendet në procedurë e sipër, atëherë gjykata vendosi ta hedhë poshtë padinë në këtë çështje për shkak të litispendencës.

Nga të lartëcekurat Gjykata në kuptim të nenit 391 pika c të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- DIVIZIONI CIVIL
C.nr.2023:186177 më dt. 13.03.2024

Gjyqtarja
Mirlinda Bytyqi Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite nga dita e pranimit Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.